



Bordi i Drejtorëve i KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, duke u bazuar në Nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 162 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Nenin 14 paragrafi 2.9 të Statutit të Kompanisë dhe Vendimin e Bordit Nr.1643, shpall këtë:

K O N K U R S

Pozita e punës: Një (1) Zyrtar i/e Lartë për Financa dhe Thesar.

Nr. i referencës së pozitës së punës: 1702/22

Përgjegjësi mbikqyrëse: Po

Raportimi: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Orari i plotë i punës: Po

Kohëzgjatja e emërimit, Periudha e punës 3 vjeçare.

Koeficientet: Në harmoni me politikat zhvillimore të Kompanisë.

Vendi i punës: Regjional.

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Harmonizimi i llogarive, kategorive të pagave dhe tarifave.
- Organizimi i departamentit të kontabilitetit duke përfshirë ngritjen e strukturës së qendrës së shërbimeve.
- Të përmirësoj dhe të mbaj nën kontroll grumbullimin e të ardhurave vjetore të njësive operative.
- Llogaritjen e shpenzimeve në kontabilitet dhe lista e pagave.
- Përgaditja në kohë e raporteve (Sistemi i informimit të menaxhmentit, drejtuar menaxhmentin të Kompanisë, Bordit, autoritet fiskale dhe ligjore)
- Përgatitja e planeve afariste dhe objektivat/krahasimi aktual.

Kualifikimi dhe aftësitë:

- Kandidatët duhet të kenë përgatitje superiore si: Fakulteti Ekonomik, 4 vjeçar apo 3+2.
- Të jetë ekspert në kontabilitet.
- Të ketë 3 vite përvojë pune në profesin, pas diplomimit.
- Të mos jetë nën hetime për vepër penale.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Dëshmia për kualifikim - Diploma e fakultetit- kopje
- CV-ja (Biografia),
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Dëshminë që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

Aplikacioni mund të merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, Rr."Enver Topalli" Nr.47 Ferizaj, ku edhe bëhet dorëzimi i Aplikacionit së bashku me dokumentacionin e kërkuar në zarf të mbyllur, apo mund të shkarkohet edhe në web-faqen e Kompanisë: www.pastertia.com.

Afati i konkursit për aplikim është i hapur 30 ditë kalendarik nga dita e publikimit në web-faqen e Kompanisë si dhe në shtypin ditor, duke filluar nga data **14.04.2022 deri më 13.05.2022 në orën 16:00**.

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025.